



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 7 Maj 2023

Nr: 462

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 351 ID, TË KOALICIONIT PËR
REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA NDAJ PERSONIT
PËRGJEGJËS TË BASHKISË TIRANË, PËR ZHVILLIMIN E VEPRIMTARISË PUBLIKE TË
NDALUAR NGA KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Sot më datë 7 Maj 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)

SUBJEKT: Z. Alban Dokushi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Tiranë

OBJEKT: Shqyrtim administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Tiranë për zhvillimin e veprimtarisë publike të ndaluar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 25.4.2023, në adresën e postës elektronike, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ka administruar denoncimin e Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), për ndalimin e veprimtarisë publike të raportuar për t’u zhvilluar me temë “*Takim me Deputetët dhe Anëtarët e rinj të*

Data: 7 Maj 2023

Nr: 462
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës në bashkinë Tiranë”

“KB”, me vend zhvillimi: “Selia PS”, më datë zhvillimi 17.4.2023, ora 17:30. Ky ndalim është pasqyruar edhe në ndërfaqen e aktiviteteve të ndaluara nga KQZ.”

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) në denoncimin e tij, ndër të tjera pretendon se *“KRIIK angazhoi një monitorues i cili në ditën dhe orën e caktuar ishte prezent në selinë e PS, për të monitoruar nëse takimi do të kryhej. Pavarësisht se monitoruesit të KRIIK iu ndalua hyrja në selinë e PS që të mund ta vëzhgonte drtjëpërdrejtë kryerjen e aktiviteti (megjithëse i pajisur me akreditimin si vëzhgues prej Komisionit Qendror të Zgjedhjeve) nga bisedat me personat e grumbulluar në hyrjen e selisë së PS ai mundi të konfirmonte se aktiviteti u zhvillua pavarësisht ndalimit të vendosur nga KQZ.”*

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcaktojnë kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Është administruar raportimi i kryer nga personi përgjegjës për bashkinë Tiranë, ku bëhet me dije se: më datë 12.4.2023, Bashkia Tiranë ka raportuar veprimtarinë publike me objekt *“Takim me Deputetët dhe Anëtarët e rinj të “Këshillit Bashkiak”*, për t’u zhvilluar në datë 17.4.2023, në orën 17:30. Në raportim është shënuar se pjesëmarrës në aktivitet do të jetë Kryetari i Bashkisë, deputetë dhe të tjerë.

Nëpërmjet vendimit nr. 367, datë 15.4.2023, “Për ndalimin e zhvillimit të veprimtarive publike, të bashkisë Tiranë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përputhje me nenin 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator është vendosur ndalimi i zhvillimit të veprimtarisë publike, të datës 17 Prill 2023, me temë *“Takim me Deputetë dhe Anëtarët e Rinj të “KB”*”.

Vendimmarrja e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, është bazuar në arsyetimin se nga të dhënat e paraqitura në raportim ka konstatuar se, aktivitetet e raportuara nga institucioni publik, Bashkia Tiranë, me pjesëmarrjen e personave partiakë, në kuadër të fushatës zgjedhore, përbëjnë veprimtari të ndaluara, në kuptim të nenit 91, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Një prej aktiviteteve të ndaluara për t’u zhvilluar ishte edhe ai me temë *“Takim me deputetë dhe anëtarët e rinj të KB”*, me vend zhvillimi: *“Selia PS”*, me datë zhvillimi 17.4.2023, ora

17:30. Ky ndalim është pasqyruar edhe në ndërfaqen e aktiviteteve të ndaluara në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Në vijim të procedurave administrative, nëpërmjet adresës së postës elektronike, po në datën 15.4.2023, personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, për bashkinë Tiranë, z. Alban Dokushi, i është bërë njoftimi i vendimin nr. 367, datë 15.4.2023, të Komisionierit Shettëror të Zgjedhjeve, mbi ndalimin e zhvillimit të aktivitetit, të përcaktuar dhe në pikën “b”, të dispozitivit të këtij vendimi.

Pas këtij njoftimi, bashkia Tiranë më datë 25.4.2023, nëpërmjet adresës elektornike e-mail, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, për bashkinë Tiranë, i cili ndër të tjera, bën me dije se: *“Kryetari i bashkisë në këto aktivitete merr pjesë si kandidat i Partisë Socialiste në zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023, si edhe në cilësinë e kryetarit të Partisë Socialiste Tiranë dhe njëherazi dhe drejtues politik i qarkut Tiranë. Aktivitetet kanë të bëjnë jo me veprimtari publike të kryetarit të bashkisë Tiranë, por kanë të bëjnë me aktivitete politike të z. Veliaj, në cilësinë e kandidatit dhe funksioneve politike që ai mban në Partinë Socialiste.”*

Në përfundim të hetimit administrativ si dhe verifikimit të rrethanave dhe fakteve, provohet se:

Aktiviteti i mësipërm është aktivitet politik dhe personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, për bashkinë Tiranë, ka gabuar në raportimin e këtij aktiviteti. Aktiviteti ka pasur për objekt “Takim me Deputetët dhe Anëtarët e rinj të KB” dhe është raportuar në ndërfaqe e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i planifikuar për t’u zhvilluar më datë 17.4.2023.

Veprimtaria është gjykuar apriori si e ndaluar, për shkak se ishte raportuar nga një institucion publik dhe kishte pjesëmarrje deputetësh. Pas administrimit të përgjigjes nga personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, u provua se veprimtaria e kryer është veprimtari politike.

Sikurse përcaktohet në pikën 1, të nenin 92, të Kodit Zgjedhor **“Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre”** detyrimi për raportim rëndon vetëm **mbi institucionet** publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore.

U vlerësua së aktiviteti i mësipërm nuk është aktivitet institucional por politik dhe si i tillë nuk duhej mbarte detyrimin për raportim në ndërfaqene dedikuar për këtë qëllim.

Në këto kushte, duhet të pushohet procedimi administrativ dhe t'i tërhiqet vëmendja personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, dhe duhet të tregohet kujdes i shtuar mbi vlerësimin e duhur të veprimtarive të cilat parashikohen nga legjislacioni në fuqi për t'u raportuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", pika 2, nenin 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj z. Alban Dokushi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike për bashkinë Tiranë.
2. Tërheqje vëmendje për raportimin e veprimtarive publike në mënyrë korrekte sipas parshikimeve ligjore.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 7 Maj 2023

Nr: 462
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës në bashkinë Tiranë”